



АГЕНЦИЈА ЗА ФИНАНСИСКА ПОДДРШКА ВО ЗЕМЈОДЕЛСТВОТО И РУРАЛНИОТ РАЗВОЈ

Në bazë të nenit 7, alineja 9 të Ligjit për themelim të Agjencisë për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta Zyrtare" e Republikës së Maqedonisë nr. 72/07, 5/09, 43/14, 193/15, 39/16 dhe 164/18), Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillim rural shpall

THIRRJE PUBLIKE nr. 06/2019 për parashtrimin e kërkesave për pagesë të mjeteve nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019

I. LËNDA E SHPALLJES

Lëndë e kësaj shpallje është shpërndarja e mbështetjes financiare për masat në vijim:

| Kodi i masës | Emri i masës | Vlera maksimale e shpenzimeve të pranueshme |
|--------------|---|---|
| 121 | Investime për modernizimin e ekonomive bujqësore | |
| 1 | Furnizim të amzave të bletëve nga vendet e miratuara për kultivimin e amzave të bletëve në pajtim me Ligjin për blegtori | deri 600.000 denarë shpenzime të pranueshme për shfrytëzues individual |
| 2 | Furnizim të derrave me pedigree gjak të pastër ose hibride (të llojit nerez dhe nazimki) nga importi ose organizata të pranuar në pajtim me Ligjin për blegtori | deri 6.500.00denarë shpenzime të pranueshme për shfrytëzues individual |

II. SHFRYTËZUES

Të drejtë në shfrytëzim të mjeteve kanë subjektet në vijim

| Subjekte |
|---|
| Ekonomitë bujqësore të regjistruara në Regjistrin e vetëm të ekonomive bujqësore (RVEB) në Ministrinë e bujqësisë, pylltarisë dhe ekonomisë, në pajtim me Ligjin për bujqësi dhe zhvillimin rural |

III. SHUMA E MBËSHETJES FINANCIARE

Mjetet janë të parapara për furnizim të amzave, derrave nerez dhe nazimki në periudhën prej 01 janar deri 30 shtator 2019.

Për masën 121, mbështetja financiare paguhet në principin e ko-financimit të investimeve e mbaruara dhe të paguara nga ana e shfrytëzuesit në shumën prej 50% nga vlera e shpenzimeve të pranueshme të miratuara për investime.

Shifra për ko-financim rritet në rastet kur:

- bëhet fjalë për investime të ekonomisë së bujqësisë bartësi i të cilit është fermer i ri deri më 55%
- për investimet në rajon me mundësi të kufizuara në prodhimtarinë bujqësor deri 60%
- për investime në rajon me mundësi të kufizuara në prodhimtari bujqësore kur bartësi i investimit është fermer i ri 65%
- për investime në komunitete rurale të paarrishme 75%

IV. KUSHTET PËR SHFRYTËZIM TË MJETEVE DHE DOKUMENTACIONI I CILI PARASHTROHET

Kërkesat parashtrihen në mënyrë elektronike pas regjistrimit të realizuar në e-baranje.ipardpa.gov.mk
Një kërkesë mund të parashtrijë vetëm një kërkesë për një masë ose më së shumti 2 kërkesa për masa të ndryshme duke i marrë parasysh edhe masat tjera nga Programi për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019.

Kushtet të cilat duhet t'i plotësojnë kërkesit e mjeteve janë të përcaktuara me:

- Programin për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019 ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë" nr.181/2019).
- Ligjin për bujqësi dhe zhvillim rural ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë" nr. 49/10, 53/11, 126/12, 15/13, 69/13, 106/13, 177/14, 25/15, 73/15, 88/15, 154/15, 11/16, 53/16, 120/16, 163/16, 74/17, 83/18, 27/19 dhe 152/2019)
- Rregulloren për kushtet plotësuese më të përafërta për mbështetjen e masave për zhvillimin rural, shpenzimet e pranueshme dhe shuma e mbështetjes për shpenzimet e pranueshme për shfrytëzues për masë individuale. ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë nr. 124/2011, 80/2013, 72/2014, 88/2015, 35/2016 dhe 101/2017)
- Rregulloren për kriteret e përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve sipas masave për zhvillimin rural ("Gazeta zyrtare e R.Maqedonisë" nr. 124/11, 80/13, 35/16, 101/17 dhe 162/18)

Kërkesit e mbështetjes financiare është e nevojshme të krijojnë kërkesë elektronike për pagesë të mbështetjes financiare me të dhënat e kërkuara dhe të bashkëngjisin dokumentet e obligueshme elektronike (fatura ose vërtetim të llogarisë me të cilat i dëshmojnë shpenzimet e realizuara, dërgesat e hollësishme për amza/bagëti të porositura, të vërtetuara në mënyrë të rregullt, Vendim për regjistrim të ekonomisë së bujqësisë në ERZS pranë MBPEU jo më të vjetër se një muaj nga dita e publikimit të thirrjes publike, llogari fiskale ose vërteti për pagesë PP30 me deklaratën e pagesës ose urdhëresën e pagesës PP10 për deklaratë e pagesës në emër të furnizuesit, formular të Marrëveshjes të vërtetuar në mënyrë të rregullt me nënshkrim dhe vulë dhe të tjera).

Kërkesit të cilët i kanë plotësuar kushtet për shfrytëzim të mjeteve radhiten me vlerësim me pikë të përcaktuar në Rregulloren për kriteret e përafërta për zgjedhje të shfrytëzuesve të masave për zhvillimin rural

- Kërkesat me numër të njëjtë të pikëve do të radhiten sipas datës dhe kohës së parashtrimit të kërkesës elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk

- Kërkesat të cilat nuk janë të parashtruara në mënyrë elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk nuk do të shqyrtohen.

Shfrytëzuesit e mjeteve duhet t'i kenë të shlyera të gjitha obligimet financiare ndaj Ministrisë për bujqësi, pylltari dhe ekonomisë së ujërave si dhe obligimet financiare ndaj Ndërmarrjes publike për ekonomizim me kullota dhe kompensim të ujit ndaj ndërmarrjeve të ekonomisë së ujërave.

Kërkesit të cilët kanë qenë shfrytëzues të mbështetjes financiare për furnizim të traktorëve përmes IPARD Programit dhe Programeve nacionale për mbështetje financiare të zhvillimit rural për pesë vitet e kaluara, nuk janë të pranueshëm si shfrytëzues të kësaj mase.

V. MARRJA E FORMULARËVE DHE UDHËZIMET

Udhëzimi për regjistrim të kërkesve në sistemin për parashtrim elektronik të Kërkesës për pagesë mund të merret në faqen fillestare në e-baranje.ipardpa.gov.mk. Udhëzimi për shfrytëzues për masë individuale mund të merret pas fillimit të krijimit të kërkesës për masën.

VI. MËNYRA E DORËZIMIT TË DOKUMENTEVE

Kërkesa e plotësuar elektronike për pagesë të Programit për mbështetje financiare të zhvillimit rural për vitin 2019 në gjuhën maqedonase, e vërtetuar në mënyrë të rregullt me nënshkrim dhe vulë nga kërkesi, së bashku me dokumentacionin e tërësishëm të duhur **original** parashtrihet në zarf të mbyllur me shenjë në anën e përparmë të zarfit në këndin e lartë të majtë "MOS E HAP" Kërkesë për pagesë dhe Numri arkivor i Kërkesës (0619-12125-XXXX/1).

Kërkesa mund të parashtrihet përmes postës ose personalisht në sportelin e Agjencisë, në të kundërtën Agjencia nuk merr përgjegjësi për arrije jo në kohë ose të pakompletuar në sportel ose për hapje të parakohshme të kërkesës

VËREJTJE:

Kërkesat që nuk janë parashtruar në mënyrë elektronike në e-baranje.ipardpa.gov.mk nuk do të shqyrtohen.

Afati përfundimtar për parashtrimin e kërkesave për pagesë është 01.10.2019.

Kërkesat e parashtruara pas afatit të paraparë nuk do të shqyrtohen.

Formulari i marrëveshjes, në 4 shtojca (ORIGINAL), i vërtetuar në mënyrë të rregullt me nënshkrim dhe vulë të kërkesit, të parashtrihet me dokumentacionin e tërësishëm deri te Agjencia!

Informacione më të hollësishme në kontakt tel. (02) 3097-460 ose në e-mail adresën dhe ueb-faqen www.ipardpa.gov.mk.

Kontakt:

Agjencia për mbështetje financiare në bujqësi dhe zhvillimin rural,
Sektori për miratim të pagesës
Telefoni 02 3097-460, çdo ditë pune nga ora 10:00 deri 14.00
E-mail: ipardpa.info@ipardpa.gov.mk



АГЕНЦИЈА ЗА ФИНАНСИСКА ПОДДРШКА ВО ЗЕМЈОДЕЛСТВОТО И
РУРАЛНИОТ РАЗВОЈ